



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 1761 prot.

Shkodër, më 27.01. 2026

VENDIM

Nr. 2 datë 26.01.2026

PËR MIRATIMIN E KRITEREVE PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR FAMILJET APLIKUESE QË NUK JANË SHPALLUR PËR FITUESE NGA SISTEMI I PIKËZIMIT DHE QË DO TË TRAJTOHEN NGA FONDI SHITESË MBI FONDIN E KUSHTËZUAR PËR NDIHMËN EKONOMIKE, DERI NË 6 PËR QIND.

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 26.01.2026, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, bazuar në Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; Ligjin nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; VKM nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, Kreu IV, pika 1; si dhe dokumentacionin e përgatitur nga administrata e Bashkisë Shkodër,

VENDOSI:

1. Miratimin e kriterëve për përzgjedhjen e familjeve në nevojë që do të trajtohen nga fondi shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike, deri në 6 për qind, sipas tabelës bashkëlidhur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

Miratuar me 36 vota

Vota Pro	36
Vota Kundër	0
Vota Abstenim	0
Zbardhur me datë	27.01.2026

SEKRETARE

Sabina Danaj



Adresa: Rr. “13 Dhjetori”, Nr.1, Shkodër, web: www.bashkiashkoder.gov.al e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al

**KRITERET PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR FAMILJET QË DO TË
TRAJTOHEN NGA FONDI SHITESË MBI FONDIN E KUSHTËZUAR (6%).**

Nr.	KRITERET E PIKËZIMIT	PIKËT (Total 100)	DOKUMENT KONFIRMUES
1	Familje njëprindërore me një ose më shumë fëmijë të moshës deri në 18 vjeç, ku njëri prej fëmijëve është nën moshën 5 vjeç.	19	Certifikatë familjare, vërtetim shkolle.
2	Familje me 1-2 anëtarë me moshë mbi 50 vjeç secili (pa të ardhura).	17	Certifikatë familjare.
3	Familjet që kanë në përbërje persona me aftësi të kufizuara apo invalid pune.	15	Certifikatë familjare, kopje vendimi nga Kom.mjeko- ligjor.
4	Familje me 3 apo më shumë fëmijë të moshës deri në 18 vjeç, ku njëri prej fëmijëve është nën moshën 5 vjeç.	13	Certifikatë familjare, vërtetim shkolle.
5	Familje që kanë k/familjarin në burg apo për kurim brenda vendit.	11	Certifikatë familjare, vërtetim nga institucioni vuajtjes së dënimit/ose kom. mjeko-ligjor.
6	Familje në proces divorci.	9	Certifikatë familjare, vërtetim nga Gjykata.
7	Familje të ngujuara për gjakmarrje.	7	Certifikatë familjare, vërtetim ngujimi nga gjakmarrja.
8	Familje të prekura nga fatkeqësitë natyrore.	5	Certifikatë familjare, konfirmim nga sektori i emergjencave civile pranë bashkisë.
9	Familje që kanë anëtarë madhor të humbur apo zhdukur dhe si të tillë nuk mund të paraqiten tek administratori çdo tre muaj për deklaram.	3	Certifikatë familjare, vendim/vërtetim nga Gjykata.
10	Çdo kategori tjetër familje në nevojë e cila nuk mund të plotësojë nevojat bazë jetike.	1	Certifikatë familjare.